



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL  
DREJTORIA E LEGJISLACIONIT DHE SIGURISË NË OPERIM

Nr. 1610 prot.

Tiranë, më 26. 6 .2024

VENDIM

Nr. 75 , datë 26. 6 .2024

PËR

MIRATIMIN E “MATERIAL UDHËZUES PËR CERTIFIKIMIN E AERODROMEVE  
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të pikës ë, të nenit 14, të Ligjit Nr.53/2022 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Aviacionit Civil”:

V E N D O S A

1. Miratimin e ACAA-DAD-GM8-CA “Material udhëzues për certifikimin e aerodromeve në Republikën e Shqipërisë”, Lëshimi 01, Rishikimi 00.
2. Ngarkohet Drejtoria e Aerodromeve, të sigurojë shpërndarjen dhe përdorimin e këtij materiali udhëzues tek operatorët.
3. Procedura e jashtme O1.PRC.01 “Për certifikimin e aerodromeve në zbatim të Urdhrit të Ministrit Nr.122/2019”, shfuqizohet.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR EKZEKUTIV

Maksim Et'hemaj





REPUBLIC OF ALBANIA



ALBANIA CIVIL AVIATION AUTHORITY

MATERIAL UDHËZUES PËR CERTIFIKIMIN E AERODROMEVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

ACAA-DAD-GM8-CA

Issue: 01, Revision 00

Date: 26.06.2024

Approved by:

Maksim Et'hemaj



Executive Director of Albanian Civil Aviation Authority

**Intentionally Left Blank**

## 0.ADMINISTRATION

### 0.1 Contents

0.ADMINISTRATION .....	3
0.2 Lista e faqeve ekzistuese.....	5
0.3 Pikat kryesore të rishikimit .....	5
0.4 Tabela e miratimit.....	5
0.5 Lista e shpërndarjes .....	6
0.6 Përkufizimet .....	6
HYRJE .....	9
KAPITULLI 1: TË PËRGJITHSHME .....	12
1.1 Qëllimi dhe zbatueshmëria .....	12
1.2 Dokumentat e referencës.....	13
2: PËRGATITJA E OPERATORIT TË AERODROMIT PËR PROCESIN E CERTIFIKIMIT SIPAS KËRKESAVE TË UM Nr. 58/2024.....	14
2.1 Procesi i certifikimit.....	14
2.2 Manuali i Operimeve të Aerodromit.....	16
2.3 Organizimi i operatorit të aerodromit .....	16
2.4 Vlefshmëria e certifikatës së aerodromit .....	17
2.5 Pezullimi ose revokimi i certifikatës së aerodromit .....	17
2.6 Amendimi i certifikatës së aerodromit .....	18
2.7 Transferimi i certifikatës .....	18
2.8 Aksesi në aerodrom .....	19
2.9 Përrjashtimet.....	19
3: PËRGATITJA E OPERATORIT TË AERODROMIT PËR PROCESIN E CERTIFIKIMIT/ KONVERTIMIT SIPAS KËRKESAVE TË UM 170/2022. ....	20
3.1. Etapa e përgatitjes, me qëllim të konvertimit të certifikatës/fillimin e procesit të certifikimit .....	20
3.1.1. Planifikimi i konvertimit/certifikimit.....	20
3.1.2. Fillimi i procesit të konvertimit/certifikimit.....	21
3.1.3. Propozime të operatorit të aerodromit në lidhje me Bazën e Certifikimit - CB .....	23
3.1.4. Pajtueshmëria me kërkesat në lidhje me organizimin dhe operimet.....	25

---

3.1.5. Mjetet alternative të pajtueshmërisë - AltMOC.....	25
3.1.6. Studimet aeronautike/Vlerësimet e rrezikut.....	27
4: KËRKESAT E ZBATUESHME PËR MENAXHIMIN.....	29
4.1. Kërkesat e përgjithshme .....	29
4.2. Kërkesat e zbatueshme për personin e caktuar si menaxher përgjegjës.....	29
4.3. Kërkesat e zbatueshme për personat e caktuar në funksionet e menaxhimit dhe mbikëqyrjes së shërbimeve operative dhe të mirëmbajtjes.....	30
4.4. Kërkesat e zbatueshme për kombinimet e pozicioneve menaxheriale.....	30
4.5. Kërkesat e zbatueshme për personin e caktuar si Menaxher i Sigurisë në Operim .....	31
4.6. Kërkesat e zbatueshme për personin e caktuar si përgjegjës për monitorimin e pajtueshmërisë .....	31
4.7 Ndikimi i ndryshimeve të zbatueshme për personelin që zë poste menaxheriale me ndikim në sigurinë në operim .....	32
SHTOJCAT.....	33
Shtojca 1 – Bazat e certifikimit .....	34
Shtojca 2 – Bazat e operimit.....	68
Shtojca 3 – Manuali i Aerodromit .....	100
Shtojca 4 – Format sipas UM 170/2022.....	125



## 0.2 Lista e faqeve ekzistuese

Pages	Issue	Revesion	Effective page
-------	-------	----------	----------------

## 0.3 Pikat kryesore të rishikimit

Lëshimi Nr.	Rishikimi	Data	Amenduar nga	Arsyet e amendimit
00	00	01.06.2020	Eda Gazheli Manjola Koleci Geri Braho	Lëshimi fillestar
01	00	25.06.2024	DAD	<ul style="list-style-type: none"><li>Hartimi i procedurës për certifikimin e aerodromit në përputhje me kërkesat e UM 58/2024.</li><li>Rishikimi i formave sipas amendimit të fundit të UM 170/2022 dhe Vendimit Nr. 15 të DE për pranimin e AMC, GM dhe CS të lëshuara nga EASA.</li><li>Formati i ri sipas ACAA-DLS-DMSP</li></ul>

## 0.4 Tabela e miratimit

Action	Emri dhe Pozicioni	Data	Signature
Përgatitur nga:	Znj. Ema Dorzi, Specialist në SAS	13/05/2024	
Rishikuar nga:	Znj. Manjola Koleci, Përgjegjëse e SAS Znj. Selma Pagria, Drejtor i DAD	27/05/2024 07/06/2024	
Kontrolluar nga:	Z. Elton Kacagjeli, Specialist në SQSC Znj. Krista Garo, Përgjegjëse e SQSC Znj. Edlira Kraja, Drejtor i DLS	21.06.2024	
Miratuar nga:	Z. Maksim Et'hemaj, Drejtor Ekzekutiv	26/06/2024	



## 0.5 Lista e shpërndarjes

Kontrolli	Personi Përgjegjës	Lloji I dokumentit
<b>Origjinali</b>	DAD SSS/DAM	Në letër
<b>Origjinali (Elektronik)</b>	DAD Staff	Kopje elektronike DRMS

## 0.6 Përkufizimet

- Shprehjet specifike të përdorura në këtë rregullore korrespondojnë me përkufizimet në Urdhrin e Ministrit të Infrastrukturë dhe Energjisë Nr. 170, datë 13/09/2022 “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e kërkesave dhe procedurave administrative që lidhen me aerodromet në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM Nr. 1095, datë 24.12.2020 Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil (Përafrim me Rreg. (BE) Nr. 2018/1139, datë 04.07.2018), si dhe Urdhri i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 58, datë 13.03.2024 “Për miratimin e rregullores për certifikimin e aerodromeve civile në Republikën e Shqipërisë, si dhe detyrimet dhe përgjegjësitë e operatorëve të aerodromeve”;
- Nocione të tjera ose terma të tjerë në kuptimin e procedurës aktuale kanë këto kuptime:

Emërtimi	Përkufizimi
<b>Baza e Certifikimit (CB)</b>	<p>Një sërë dispozitash që përbëhen nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- specifikimet e vlefshme të certifikimit (CS), kundrejt të cilave aplikanti duhet të tregojë pajtueshmëri;</li> <li>- çdo dispozitë për të cilën AAC, ka pranuar që aplikanti të provojë një nivel ekuivalent të sigurisë në operim (ELOS); dhe</li> <li>- çdo kusht i veçantë (SC) që AAC, e konsideron të nevojshëm të përfshihet në bazën e certifikimit.</li> </ul> <p>AAC krijon dhe njofton aplikantin mbi bazën e certifikimit, e cila është unike për secilin aerodrom.</p>



<b>Kërkesat Thelbësore (ER)</b>	Dispozitat e detyrueshme të Shtojcës I-IX të VKM Nr. 1095, datë 24.12.2020 Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil (Përafrim me Rreg. (BE) Nr. 2018/1139, datë 04.07.2018);
<b>Kushtet Speciale (SC).</b>	Specifikimet teknike të hollësishme të përcaktuara nga AAC për një aerodrom nëse specifikimet e certifikimit (CS) të përcaktuara nga EASA nuk janë adekuate ose nuk janë të përshtatshme për të siguruar përputhjen e aerodromit me kërkesat thelbësore (ER) të Shtojcës V VKM Nr. 1095, datë 24.12.2020 Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil (Përafrim me Rreg. (BE) Nr. 2018/1139, datë 04.07.2018);
<b>Materiali Udhëzues (GM).</b>	Materiali që ndihmon në ilustrimin e rëndësisë së një kërkesë ose specifikimi, i cili përdoret për të mbështetur interpretimin e rregullave themelore (BR), rregullave të zbatimit të tij (IR) dhe mjeteve të pranueshme të pajtueshmërisë (AMC);
<b>Rregullat e Zbatimit (IR).</b>	Urdhri i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 170, datë 13.09.2022 Për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e kërkesave dhe procedurave administrative që lidhen me aerodromet në Republikën e Shqipërisë”;
<b>Rregullat Themelore (BR).</b>	VKM Nr. 1095, datë 24.12.2020 Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil (Përafrim me Rreg. (BE) Nr. 2018/1139, datë 04.07.2018);



## 0.7 Shkurtesat dhe akronimet

Shkurtime	Shpjegimi
ADR	Aerodrom
AAC	Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar
AMC	Mjetet e pranueshme të pajtueshmërisë
AMOC	Mjetet alternative të pajtueshmërisë
AR	Kërkesat e Autoritetit
BR	Rregullat Themelore
CB	Baza e certifikimit
CS	Specifikimet e certifikimit
DAAD	Dokument i pranimit të devijimeve dhe veprimeve
DSN	Projektim (dizajnim)
EASA	Agjencia Evropiane e Sigurisë së Aviacionit
ELOS	Niveli ekuivalent i sigurisë në operim
ER	Kërkesat Thelbësore
GM	Materiali Udhëzues
ICAO	Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil
IR	Rregullat e Zbatimit
OPS	Kërkesat e Operimit
OSE	Kërkesat e organizatës
SC	Kushtet speciale
UM	Urdhër Ministri

## HYRJE

- 1) Në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.96, datë 23.08.2020 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe sipas Ligjit Nr.53, datë 29.07.2022 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Aviacionit Civil”, i ndryshuar, AAC ka si aktivitet ushtrimin e funksionit të mbikëqyrjes së sigurisë së operimit të aviacionit civil dhe të kompetencave të deleguara nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) në fushën e sigurisë së aviacionit civil.
- 2) Urdhri i Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 170, datë 13.09.2022 “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e kërkesave dhe procedurave administrative që lidhen me aerodromet në Republikën e Shqipërisë” që transponon Rregulloren e (BE) 139/2014, cakton AAC si autoritetin kompetent në certifikimin dhe mbikëqyrjen e aerodromeve, si dhe të personelit dhe organizatave të përfshira, me qëllim të ushtrimit të atribueteve që i përkasin një autoriteti të tillë, në përputhje me dispozitat e VKM Nr. 1095, datë 24.12.2020 “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil “ (Përafrim me Rreg. (BE) Nr. 2018/1139, datë 04.07.2018).
- 3) Urdhri i Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 58, datë 13.03.2024 “Për miratimin e rregullores për certifikimin e aerodromeve civile në Republikën e Shqipërisë, si dhe detyrimet dhe përgjegjësitë e operatorëve të aerodromeve” specifikon në Nenin 1 pikën 3 “Autoriteti i Aviacionit Civil (AAC) miraton/përshtat mjete përputhshmërie për arrijtjen dhe mbajtjen e një niveli të kënaqshëm të sigurisë në operim, mbështetur në rekomandimet dhe dokumentet udhëzuese të ICAO-së. “. Gjithashtu cakton AAC-në si autoritetin përgjegjës për të inspektuar operatorin e një aerodromi me fokus objektet, pajisjet, shërbimet ose procedurat operative të aerodromit dhe të inspektojë dokumentet dhe të dhënat e operatorit të aerodromit dhe të verifikojë Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë në operim në aerodrom me qëllim sigurinë në operim në aviacion.
- 4) AAC ushtron të gjitha kompetencat sipas Kodit Ajror të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, si:
  - a) përpunimi i projekteve të rregullave teknike për fushat në të cilat ka kompetenca dhe mbikëqyrja e zbatimit të tyre;
  - b) certifikimi i aerodromeve civile;
  - c) mbikëqyrja e vazhdueshme.
- 5) Rregullat Themelore (BR), si dhe Kërkesat Thelbësore (ER) që ai kufizon, transpozuar me VKM Nr. 1095, datë 24.12.2020 Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil janë të detyrueshme. Objektivi kryesor është krijimi dhe mirëmbajtja e një niveli të lartë të sigurisë së aviacionit civil në Evropë, përfshirë përmirësimin e përgjithshëm të sigurisë së aerodromit.
- 6) Rregullorja 170, datë 13.09.2022 “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e kërkesave dhe procedurave administrative që lidhen me aerodromet në Republikën e Shqipërisë” përmban standarde të detyrueshme që përdoren për zbatimin e Kërkesave Thelbësore (BR) të rregullores. Ajo përcakton rregulla të hollësishme në lidhje me:

- a) kushtet në të cilat baza e certifikimit e zbatueshme për një aerodrom është vendosur dhe është njoftuar aplikanti;
  - b) kushtet për lëshimin, mirëmbajtjen, modifikimin, kufizimin, pezullimin apo revokimin e certifikatave për aerodromet, certifikatat për organizatat përgjegjëse për aerodromet operues, përfshirë kufizimet e funksionimit në lidhje me modelin e specifikuar të aerodromit;
  - c) kushtet e funksionimit të një aerodromi, në përputhje me Kërkesat Thelbësore (BR) të përcaktuara në Shtojcën V të VKM Nr. 1095, datë 24.12.2020 “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil (Përafrim me Rreg. (BE) Nr. 2018/1139, datë 04.07.2018) përgjegjësitë e mbajtësve të certifikatës.”
- 7) UM Nr. 58/2024 përmban kërkesat mbi certifikimin e aerodromeve të cilat përdoren për operim të avionëve për transport ajror ndërkombëtar dhe kombëtar të hapur për publikun, dhe nuk bien në fushëveprimin e VKM 1095/2020. Kjo rregullore transpozon Aneksin 14, Volumi I Edicioni 9, Korrik 2022.
  - 8) Për të lehtësuar respektimin e rregullave të përmendura në pikat (5) dhe (6), EASA ka zhvilluar mjetet e pranueshme të pajtueshmërisë (AMC), specifikimet e certifikimit (CS) dhe materialet udhëzuese (GM), të pranuar nga AAC dhe të detyrueshme për t'u zbatuar dhe implementuar përmes Vendimit të Drejtorit Ekzekutiv të AAC Nr. 15, datë 26.10.2022 “Për pranimin e AMC, GM dhe CS të EASA, për zbatimin e Urdhrit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 170, datë 13.09.2022”.
  - 9) Me hyrjen në fuqi të Rregullores (BE) 139/2014, AAC vendosi një plan zbatimi në bazë të të cilit u morën hapat e nevojshëm për zhvillimin e sistemit rregullator, në vijim të zbatimit të marrëveshjes shumëpalëshe për Krijimin e një Zone të Përbashkët në Fushën e Aviacionit Civil (ECAA Agreement). Kjo rregullore u transpozua në legjislacionin kombëtar përmes UM 122/2019 dhe u amendua në vijim në përputhje me amendimet e Rregullores Evropiane 139/2014 përmes Urdhrit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 170, datë 13.09.2022 “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e kërkesave dhe procedurave administrative që lidhen me aerodromet në Republikën e Shqipërisë” Gjithashtu, AAC ka pranuar AMC, GM, CS përmes Vendimit të Drejtorit Ekzekutiv Nr. 15, datë 26.10.2022, të cilin e ka bërë të aksesueshëm në website-in zyrtar si dhe ka njoftuar operatorët që bien në fushëveprimin e kësaj rregulloreje.
  - 10) Procedurat dhe udhëzimet e tanishme, paraqesin një nga elementët e detajuar të Planit të Zbatimit me qëllim:
    - a) të harmonizojë kornizën rregullatore kombëtare në fushën e aerodromeve civile me rregullat aktuale të zbatueshme evropiane dhe ndërkombëtare;
    - b) të nxjerrë në pah qasjen, përfshirjen dhe veprimet e AAC në procesin e certifikimit, sipas rregullave evropiane ose konvertimit të certifikatave kombëtare, sipas rastit, të aerodromeve që janë objekt i VKM Nr. 1095, datë 24.12.2020 Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil (Përafrim me Rreg. (BE) Nr. 2018/1139, datë 04.07.2018)

- c) t'u ofrojë operatorëve të aerodromit dhe ofruesve të shërbimeve të menaxhimit të apronit udhëzime të hollësishme se si t'i kryejnë ato në pajtueshmëri me dispozitat e Urdhrit të Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 170, datë 13.09.2022 "Për miratimin e rregullores "për përcaktimin e kërkesave dhe procedurave administrative që lidhen me aerodromet në Republikën e Shqipërisë";
  - d) tu ofrojë operatorëve të aerodromeve që bien në fushëveprimin e Rregullores 58/2024, udhëzimi mbi procesin e certifikimit, hapat që duhet të ndiqen dhe format që duhet të përdoren.
  - e) të rrisë ndërgjegjësimin për industrinë, në veçanti operatorët e aerodromit dhe ofruesit e shërbimeve të menaxhimit të apronit, si dhe për të lehtësuar të kuptuarit e kërkesave dhe proceseve të reja;
  - f) të lejojë zbatimin e duhur të mekanizmave specifik të certifikimit, sipas rregullave kombëtare, në përpjestim me madhësinë, trafikun, kategorinë dhe kompleksitetin e aerodromit dhe me natyrën dhe vëllimin e operimeve të kryera atje;
- 11) Procedurat dhe udhëzimet e procedurave do të zbatohen, në pjesët vijuese:
- a) Personeli i AAC i përfshirë në certifikim sipas rregullave evropiane, ndërkombëtare dhe kombëtare dhe mbikëqyrjes së aerodromit;
  - b) për operatorët e aerodromit që i nënshtrohen VKM Nr. 1095, datë 24.12.2020 Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil (Përafrim me Rreg. (BE) Nr. 2018/1139, datë 04.07.2018), në lidhje me certifikimin sipas rregullave evropiane ose konvertimin e certifikatave kombëtare;
  - c) për operatorët e aerodromeve që bien në fushëveprimin e UM Nr. 58/2024;
  - d) ofruesit e shërbimeve të menaxhimit të apronit; dhe
  - e) personeli dhe organizatat e përfshira në funksionimin e këtyre aerodromeve.

## KAPITULLI 1: TË PËRGJITHSHME

### 1.1 Qëllimi dhe zbatueshmëria

- 1) Procedurat dhe udhëzimet e procedurave, Pjesa 1, kanë si qëllim:
  - a) të lehtësojnë zbatimin e duhur të UM Nr. 170/2022, AMC, CS, GM, UM Nr. 58/2024, si dhe mekanizmat specifikë për përgatitjen dhe fillimin e procesit të certifikimit/konvertimit, sipas rastit;
  - b) të përcaktojnë detyrimet, përgjegjësitë dhe veprimet e AAC dhe të operatorëve të aerodromit gjatë periudhës së përgatitjes dhe fillimit të procesit të certifikimit, ose konvertimit të certifikatave kombëtare (më poshtë referuar si certifikim/konvertim), sipas rastit, për aerodromet në Shqipëri i nënshtrohet VKM Nr. 1095, datë 24.12.2020 Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil (Përafrim me Rreg. (BE) Nr. 2018/1139, datë 04.07.2018).
- 2) Procedurat dhe udhëzimet, Pjesa 1, do të zbatohen në pjesët vijuese:
  - a) për personelin e AAC të përfshirë në certifikimin e aerodromit;
  - b) Për operatorët e aerodromit që i nënshtrohen VKM Nr. 1095, datë 24.12.2020 Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil (Përafrim me Rreg. (BE) Nr. 2018/1139, datë 04.07.2018), në lidhje me përgatitjen dhe fillimin e procesit të certifikimit/konvertimit, sipas rastit.
  - c) Për operatorët e aerodromeve që bien në fushëveprimin e UM Nr. 58/2024.
- 3) Përcaktimi i pajtueshmërisë me UM Nr. 170/2022 dhe me rregullat e tij zbatuese, AAC, operatorët e aerodromit ose ofruesit e shërbimeve të menaxhimit të apronit do të përdorin mjetet e pranueshme të pajtueshmërisë (AMC), materialet udhëzuese (GM), si dhe specifikimet e certifikimit (CS) për hartimin e aerodromeve (CS-ADR-DSN), në versionin e miratuar dhe publikuar nga EASA, përfshirë ndryshimet vijuese të tij.
- 4) Kur dy ose më shumë AMC tregojnë për pajtueshmëri me një rregull, ato korrespondojnë si pjesë përbërëse të një rregulli për të përmbushur rregullat në fjalë. Të gjitha AMC-të e ofruara duhet të zbatohen/respektohen.
- 5) Për të arritur përputhjen me rregullat zbatuese, AAC, operatorët e aerodromit ose ofruesit e shërbimeve të menaxhimit të apronit mund të përdorin gjithashtu mjete alternative të pajtueshmërisë (AMOC), të cilat do të duhet të pranohen nga AAC në vijim të garantimit të të njëjtit nivel të sigurisë.
- 6) Pasi operatori i aerodromit të marrë përsipër me anë të deklaratës së pajtueshmërisë, një AMC ose një AMOC duhet të zbatohet si një mënyrë për t'u pajtuar me rregulloren.

- 7) Pas përzgjedhjes për secilin aerodrom të CS-ve specifike, dhe identifikimit të atyre që janë objekt e një zgjidhjeje alternative të pajtueshmërisë (ELOS, SC); këto bëhen të zbatueshme përmes bazës së certifikimit (CB).
- 8) Proceset/procedurat për autorizimin apo regjistrimin e aerodromeve civil në nivelin kombëtar do t'i nënshtrohen akteve normative specifike.
- 9) Të gjitha kërkesat e përcaktuara në UM Nr. 58/2024 lidhur me certifikimin dhe mbikëqyrjen e aerodromeve, duhet të zbatohen nga operatorët e aerodromeve që bien në fushëveprimin e kësaj rregulloreje.

## 1.2 Dokumentat e referencës

- Ligji Nr. 96/2020 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”;
- Urdhri i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 170, datë 13.09.2022 “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e kërkesave dhe procedurave administrative që lidhen me aerodromet në Republikën e Shqipërisë”;
- Urdhri i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 58, datë 13.03.2024 “Për miratimin e rregullores për certifikimin e aerodromeve civile në Republikën e Shqipërisë, si dhe detyrimet dhe përgjegjësitë e operatorëve të aerodromeve”
- Vendimi i Drejtorit Ekzekutiv të AAC-së Nr. 15, datë 02.10.2022 “Për pranimin e AMC, GM dhe CS të EASA për zbatimin e Urdhrit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 170, datë 13.09.2022”;
- VKM Nr. 1095, datë 24.12.2020 Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil (Përaftrim me Rreg. (BE) Nr. 2018/1139, datë 04.07.2018);
- Dok 9859 ICAO - Manual për menaxhimin e sigurisë në operim, Ed.4/2018;
- Dok 9981 ICAO - PANS-Aerodromet, Ed. 3/2020;
- Dok 9774 ICAO – Manual mbi certifikimin e aerodromeve.

## 2: PËRGATITJA E OPERATORIT TË AERODROMIT PËR PROCESIN E CERTIFIKIMIT SIPAS KËRKESAVE TË UM Nr. 58/2024.

### 2.1 Procesi i certifikimit

2.1.1 Në përputhje me kërkesat e Nenit 5 “Aplikimi për një certifikatë të aerodromit”, të UM Nr. 58/2024, një subjekt mund të aplikojë pranë AAC-së për një certifikatë të aerodromit, për të operuar një aerodrom në vendin e përcaktuar në kërkesë. Kërkesa duhet të jetë sipas formës ACAA-DAD-AIM-400 “Forma e aplikimit për certifikatë të aerodromit sipas kërkesave të UM 58/2024”, të cilën aplikanti mund ta aksesojë në faqen e web të AAC-së. Gjithashtu, subjekti i interesuar duhet të përcjellë në AAC evidenca të koordinimit të nevojshëm (marrëveshje, LoA etc) me agjencitë e tjera dhe ofruesit e shërbimeve, të tilla si shërbimet e informacionit aeronautike, shërbimet e trafikut ajror, autoritetet meteorologjike, autoritetet mjedisore, autoritetet që lidhen me sigurinë (security), autoritetet locale të planifikimit për të siguruar operimet e sigurta të avionëve.

2.1.2 Kërkesa për marrjen e Certifikatës së Aerodromit do të dërgohet në AAC nga subjekti i interesuar për operim, së bashku me një hartë që tregon vendndodhjen dhe kufijtë e aeroportit dhe 2 (dy) kopje të Manualit të Operimit të Aeroportit.

2.1.3 Subjekti i interesuar ose operatori, do të japë të dhëna për të gjitha studimet, hartat (Charts), profilet, seksionet, dëshmitë për rëndësinë e infrastrukturës së fluturimit dhe zonat më të rëndësishme përreth tyre.

2.1.4 AAC do të vlerësojë shprehjen e interesit për certifikimin e një aerodromi dhe do të udhëzojë aplikantin brenda 30 ditëve nga marrja e aplikimit lidhur me vijimin e aplikimit zyrtar ose mbi nevojën për plotësimin e dokumentacionit.

2.1.5 Nëse vlerësimi i shprehjes së interesit tregon se nevojiten veprime të mëtejshme ose dokumente shtesë, AAC do t'i dërgojë aplikantit një letër zyrtare ku kërkon informacion ose veprime shtesë. Në rastin e veprimeve të mëtejshme ose dokumenteve shtesë, afati kohor i përcaktuar në pikën 2.1.4 më sipër do të shtyhet për aq kohë sa aplikanti do të plotësojë kërkesat e AAC-së për veprime shtesë.

2.1.6 AAC duhet të bindet që funksionimi i një aerodromi në vendndodhjen e specifikuar në aplikim nuk do të rrezikojë sigurinë e avionit. Nëse rezultatet e këtij vlerësimi do të jenë negative, atëherë aplikanti do të njoftohet menjëherë nga AAC.

2.1.7 Për të lehtësuar koordinimin dhe zbatimin e aktiviteteve të certifikimit sipas kërkesave të UM Nr. 58/2024, si në nivelin e AAC ashtu edhe në nivelin e operatorëve të aerodromit, do të caktohen personat përgjegjës të trajnuar në përputhje me procedurat e brendshme të aplikueshme.

2.1.8 Për planifikimin fillestar të certifikimit të një aerodromi, operatori i aerodromit, duhet të hartojë Programin e Certifikimit, ku të parashikojë veprimet që duhen kryer sipas fazave dhe ta përcjellë atë në AAC. Gjatë hartimit të këtij programi duhet patur parasysh se veprimi administrativ për dhënien ose refuzimin e certifikatës, në përputhje me kërkesat e urdhrit të ministrit nr. 58/2024, duhet të kryhet brenda gjashtë muajve nga marrja e aplikimit zyrtar nga aplikanti. Çdo kërkesë për shtyrjen e afatit duhet të arsyetohet dhe miratohet nga AAC.



2.1.9 AAC duhet të kryejë vlerësimin e aplikimit zyrtar dhe dokumentacionit të përcjellë bashkëlidhur këtij aplikimi brenda 60 ditëve dhe duhet të informojë aplikantin lidhur me vijimin e procesit ose nevojën për dokumentacion shtesë.

2.1.10 Në rast se vlerësohet se aplikimi mund të vijojë, AAC do të kryejë inspektimin/auditimin në terren me qëllim të vlerësimit të objekteve, shërbimeve dhe pajisjeve të aerodromit për të verifikuar dhe siguruar që ato janë në përputhje me kërkesat e UM Nr. 58/2024. Auditimi duhet të kryhet brenda 90 ditëve nga marrja e aplikimit zyrtar. Gjatë auditit duhet të verifikohet, por pa u kufizuar në:

1. Dimensionet dhe kushtet e sipërfaqes së:
  - pistës;
  - shpatullave të pistës;
  - rripit të pistës;
  - zonës së sigurisë në fund të pistës;
  - zonës së ndalimit dhe zonave të pastra;
  - rrugëve lidhëse;
  - shpatullave të rrugëve lidhëse;
  - rripit të rrugëve lidhëse.
2. Prezencën e pengesave në sipërfaqet me kufizim pengesash dhe në afërsi të aerodromit.
3. Dritat e mëposhtme aeronautike tokësore, duke përfshirë të dhënat e tyre të kontrollit të fluturimit:
  - ndriçimi i pistës dhe rrugës lidhëse;
  - dritat e sistemit të afrimit;
  - PAPI/APAPI ose T-VASIS/AT-VASIS;
  - ndriçuesit e vendqëndrimeve;
  - ndriçuesit e pengesave;
  - sistemet e drejtimit vizual për parkimin e avionëve.
4. Furnizimin me energji elektrike, burimet primare dhe sekondare;
5. Treguesi i drejtimit të erës;
6. Ndriçimi i treguesve të drejtimit të erës;
7. Vijëzimet dhe shënjesit e aerodromit;
8. Shenjat e aerodromit;
9. Pajisjet dhe instalimet e Shërbimit të Shpëtimit dhe Zjarrëfikjes;
10. Pajisjet e mirëmbajtjes së aerodromit, veçanërisht për mirëmbajtjen e fasiliteve në zonat e lëvizjes, duke përfshirë matjen e fërkimit të sipërfaqes së pistës;
11. Pastrues të pistës dhe pajisje për heqjen e borës;
12. Pajisje për largimin e avionit të dëmtuar;
13. Procedurat dhe pajisjet e menaxhimit të kafshëve të egra;
14. Radio me dy drejtime të instaluar në automjete për përdorim nga operatori i aerodromit në zonën e lëvizjes;

15. Prania e dritave që mund të rrezikojnë sigurinë e avionit;
16. Fasilitetet për furnizimin me karburant.

2.1.11 Bazuar në rezultatet e auditit AAC do të hartojë dhe do ti përcjellë aplikuesit, Raportin e Auditimit me gjetjet përkatëse.

2.1.12 Subjekti aplikues duhet të hartojë dhe përcjellë në AAC Planin e Veprimeve Korrigjuese, sipas afateve të përcaktuara në procedurat e mbikëqyrjes së AAC-së, mbi të cilat operatori do të njoftohet zyrtarisht nga AAC gjatë përcjelljes së raportit të inspektimit. Plani i Veprimeve korrigjuese duhet të adresojë gjetjet e ngritura me masa korrigjuese, afate respektive për mbylljen e gjetjeve, rrënjën e shkakut (root cause), dhe departamentet përgjegjëse për mbylljen e gjetjeve.

2.1.13 Pas përfundimit të procesit të certifikimit, kur verifikohet se operatori i aerodromit përmbush kërkesat e zbatueshme, AAC do të lëshojë certifikatën e aerodromit dhe informacioni rreth aerodromit duhet t'i jepet shërbimi i informacionit aeronautik për publikim.

## **2.2 Manuali i Operimeve të Aerodromit**

2.2.1 Manuali i Aerodromit duhet të jetë në përputhje me kërkesat e Kapitullit 2 – “Manuali i Operimit të Aerodromit”, të Urdhrit të Ministrisë 58/2024.

2.2.2 Përveç Manualit të Aerodromit, aplikantit mund t'i kërkohej të paraqesë dokumente shtesë, si për shembull Procedurat Standarde të Operimit të referuara në Manual.

2.2.3 Manuali i Operimeve të Aerodromit duhet të nënshkruhet nga Menaxheri përgjegjës i aerodromit.

2.2.4 Manuali i Operimeve të Aerodromit duhet të organizohet në një mënyrë që të lehtësojë përgatitjen dhe procesin e rishikimit.

## **2.3 Organizimi i operatorit të aerodromit**

2.3.1 Operatori do t'i demonstrojë AAC-së se organizimi i biznesit të tij dhe procedurat e menaxhimit janë të duhurat dhe të përshtatshme, për llojin e operimeve të miratuara për aeroportin dhe të operimit të aeroportit, në vazhdimësi, me efikasitet dhe transparencë.

2.3.2 Operatori i Aerodromit bën të njohur emrat dhe statusin e menaxherëve të mëposhtëm, të cilët janë subjekt pranimi nga AAC:

- Menaxheri Përgjegjës, i cili është personi i caktuar nga operatori i aerodromit dhe që ka autoritetin dhe autonominë e nevojshme për të siguruar që të gjitha aktivitetet kryhen në përputhje me kriteret e certifikimit;
- Menaxherët Përgjegjës ose menaxherët raportues për:
  - a. Zonën e lëvizjes;
  - b. Terminalin;
  - c. Mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe sistemeve;

- d. Raportimin në zyrën e AIS dhe kontrollin e trafikut ajror për çdo ndryshim të kushteve ose çdo ngjarje tjetër në aerodrom që ndikon në funksionimin e sigurisë së avionit; dhe
- e. Garantimin e funksionimit të sigurisë gjatë kryerjes së punimeve në aerodrom;
- f. Ngritjen dhe zbatimin Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë në Aerodrom.

2.3.3 AAC mund të kërkojë të intervistojë menaxherët përgjegjës të nominuar lidhur me kualifikimet e tyre dhe të dhëna shtesë që mund të kërkoen gjatë procesit të vlerësimit të tyre.

2.3.4 Menaxheri përgjegjës ose menaxherët raportues duhet të kenë kualifikimet e duhura dhe kompetenca menaxheriale në sektorin e aeroportit. Pas vlerësimit nga AAC-ja, një menaxher mund të mbajë më shumë se një detyrë në aeroport. Lidhur me këtë, operatori i aerodromit duhet të përcjellë pranë AAC-së CV, certifikatat e trajnimit dhe çdo dokument që vërteton kualifikimet e menaxherëve.

2.3.5. Në AOM duhet të përshkruhen kompetencat dhe përgjegjësitë e menaxherëve. Duhet, gjithashtu, të krijohet procedura të veçanta për të siguruar vazhdimësinë e menaxhimit në mungesë të menaxhereve përgjegjës.

2.3.6. Operatorit i duhet të sigurojë që çdo fushë e organizatës të jetë e pajisur me staf të mjaftueshme për shkallën dhe kompleksitetin e operimeve dhe të kualifikuar për llojin e funksionit. Lidhur me këtë duhet të përcillet organigrama e organizatës.

2.3.7. Operatori duhet të sigurojë pajisje të përshtatshme për të siguruar menaxhimin e sigurt të operimeve dhe kushtet e përshtatshme për përdoruesit e shërbimeve të saj.

2.3.8 Operatori i aerodromit do të krijojë një sistem të menaxhimit të sigurisë për aerodromin duke përshkruar strukturën e organizatës dhe detyrat, kompetencat dhe përgjegjësitë e zyrtarëve në strukturën organizative, me qëllim që të sigurohet që operacionet të kryhen në një mënyrë të kontrolluar

2.3.9 Operatori i aerodromit duhet të hartojë Programin e Mirëmbajtjes së infrastrukturës në përputhje me kërkesat e Nenit 23 të UM Nr. 58/2024, si dhe Programin e trajnimit për stafin sipas përgjegjësisë.

## **2.4 Vlefshmëria e certifikatës së aerodromit**

2.4.1 Certifikata e Aerodromit mbetet në fuqi, deri në pezullimin ose anulimin e saj nga AAC-ja.

2.4.2 Certifikata është e vlefshme, bazuar në rezultatet e suksesshme të monitorimit të kryer nga AAC-ja gjatë periudhës së vlefshmërisë dhe të inspektimeve për vlefshmërinë e saj.

2.4.3 AAC-ja ka të drejtën të nisë procedurat e vlerësimit për vlefshmërinë e certifikatës së aerodromit edhe në mungesë të kërkesës nga ana e kërkuarit.

## **2.5 Pezullimi ose revokimi i certifikatës së aerodromit**

2.5.1 Urdhri i Ministrit Nr. 58/2024, neni 9, i jep AAC-së kompetencën ligjore për të pezulluar ose anuluar një certifikatë aerodromi nëse AAC është e bindur se ekzistojnë arsye të caktuara.

2.5.2 Në lidhje me një certifikatë aerodromi, veprimi i pezullimit/revokimit mund të fillohet nëse AAC është e bindur që mbajtësi i certifikatës:

- Ka shkelur një kusht të përcaktuar në Certifikatën e Aerodromit; OSE
- Nuk plotëson standardet e kërkuara për objektet, funksionimin ose mirëmbajtjen e aerodromit, ose
- Ka dështuar në detyrën e tij në lidhje me çdo çështje që ndikon në navigimin e sigurt të një avioni.

2.5.3 Përpara pezullimit ose anulimit të një certifikate aerodromi, AAC do t'i japë mbajtësit një njoftim që përcakton faktet dhe rrethanat që duket se justifikojnë pezullimin ose anulimin dhe duke e ftuar mbajtësin të tregojë me shkrim dhe brenda një periudhe të arsyeshme, arsyen pse certifikata nuk duhet të të pezullohet ose të revokohet.

2.5.4 AAC-ja do të shqyrtojë çdo arsye të ofruar nga mbajtësi i certifikatës brenda kohës së lejuar përpara se të marrë një vendim në lidhje me pezullimin ose revokimin.

2.5.5 Njoftimi i pezullimit ose anulimit hyn në fuqi në ditën kur i dorëzohet mbajtësit të certifikatës së aerodromit.

## **2.6 Amendimi i certifikatës së aerodromit**

2.6.1 Në përputhje me kërkesat rregullatore në fuqi, një certifikatë aerodromi ndryshohet kur:

- a. ka një ndryshim në përdorimin ose funksionimin e aerodromit;
- b. ka një ndryshim në kufijtë e aerodromit;
- c. Mbajtësi i certifikatës së aerodromit kërkon ndryshimin; ose
- d. Ka një ndryshim në pronësinë ose menaxhimin e aerodromit.

2.6.2 Aplikimi me shkrim duhet të dorëzohet në AAC të paktën 30 ditë përpara datës së synuar të ofrimit të shërbimit.

2.6.3 Në rast se kërkohet ndryshimi i certifikatës nga operatori i aerodromit, duhet që ai të ketë dorëzuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për të dokumentuar ndryshimin e propozuar, me fokus të veçantë në:

- të pasqyrojë ndryshimet në Manualin e Aerodromit dhe ta dërgojë për pranim/miratim në AAC, nëse këto ndryshime ndikojnë në përmbajtjen e manualit;
- të ndryshojë procedurat operative ose të hartojë procedura të reja sipas rastit;
- të specifikojë qartë në kërkesën për ndryshim, aspektet që preken dhe të përcjellë të gjithë dokumentacionin sipas rastit (studime, teste, harta etj.);
- Dokumente të tjera plotësuese, sipas ndryshimit të propozuar.

## **2.7 Transferimi i certifikatës**

2.7.1 Një certifikatë aerodromi nuk është e transferueshme, përveçse kur lejohet nga AAC-ja.

## 2.8 Aksesit në aerodrom

2.8.1 Personeli i autorizuar nga AAC mund të inspektojë dhe kryejë teste në objektet, shërbimet dhe pajisjet e aerodromit, të inspektojë dokumentet dhe të dhënat e operatorit të aerodromit dhe të verifikojë sistemin e menaxhimit të sigurisë së operatorit të aerodromit përpara se të jepet ose rinovohet certifikata e aerodromit dhe, më pas , në çdo kohë tjetër, me qëllim sigurimin e sigurisë në aerodrom.

2.8.2 Operatori i aerodromit, do të lejojë aksesin në çdo pjesë të aerodromit ose çdo objekti të aerodromit, duke përfshirë pajisjet, të dhënat, dokumentet dhe personelin e operatorit, për qëllimin e përmendur në pikën 2.8.1.

## 2.9 Përjashtimet

2.9.1 Kur aerodromi nuk i plotëson kërkesat e standardeve të specifikuar në UM Nr. 58/2024, operatori i aerodromit mund të aplikojë për një përjashtim në përputhje me Procedurën e AAC-së “Procedura e përjashtimit” ACAA–DLS–EXMP.

2.9.2 Kërkesa për përjashtim mund të bëhet vetëm kur nuk cënohet siguria në operim e lundrimit ajror.

2.9.3 AAC-ja mundet që, me instruksionet e saj, të lejojë përjashtimin e një operatori të aerodromit nga pajtimi me dispozitat e përcaktuara në UM Nr. 58/2024.

2.9.4 Në përputhje me standardet mbi të cilat kërkohet përjashtimi dhe në përputhje me kërkesat e procedurës së AAC-së “Procedura e përjashtimit” ACAA–DLS–EXMP aplikimi për përjashtim mund të kërkojë kryerjen e studimeve aeronautike nga operatori i aerodromit, për të garantuar se përjashtimi nuk cënon sigurinë në operim.

2.9.5 Lejimi i një përjashtimi varet nga përputhshmëria e operatorit me kriteret e specifikuar në Procedurën e AAC-së “Procedura e përjashtimit” ACAA–DLS–EXMP , të cilat të jenë të mjaftueshme në interes të sigurisë së lundrimit ajror.

### **3: PËRGATITJA E OPERATORIT TË AERODROMIT PËR PROCESIN E CERTIFIKIMIT/ KONVERTIMIT SIPAS KËRKESAVE TË UM 170/2022.**

#### **3.1. Etapa e përgatitjes, me qëllim të konvertimit të certifikatës/fillimin e procesit të certifikimit**

##### **3.1.1. Planifikimi i konvertimit/certifikimit**

- 1) Për të lehtësuar koordinimin dhe zbatimin e aktiviteteve të konvertimit/certifikimit, si në nivelin e AAC ashtu edhe në nivelin e operatorëve të aerodromit, duhen caktuar personat përgjegjës të trajnuar në përputhje me procedurat e brendshme të aplikueshme.
- 2) Për planifikimin fillestar të konvertimit të një certifikate ekzistuese të një operatori aerodromi, AAC parashikon një program të quajtur, Programi i Konvertimit, i cili informon secilin operator për fazat e fillimit të procesit të konvertimit, sipas ADR.AR.C.015 (b).
- 3) Programi i Konvertimit i përpunuar nga AAC i përmendur në 2.1.1. (2) do të diskutohet me secilin operator të aerodromit në takimet e para të punës.
- 4) AAC gjithashtu informon operatorët e aerodromit për personat përgjegjës të AAC, në mënyrë që aplikanti të marrë kohën e duhur për një informacion të plotë në lidhje me dokumentat, fazat, të dhënat apo procedurat që duhet të ndiqen për të zbatuar programin e konvertimit.
- 5) Afatet e përcaktuara për planifikimin e procesit të konvertimit në Programin e Konvertimit për secilin aplikant të konvertimit, do të përcaktohen sipas elementeve vijuese:
  - a) datën në të cilën përfundon certifikata e secilit operator të aerodromit;
  - b) projektet për modernizimin e infrastrukturës së aerodromit, nëse ekzistojnë, sipas rastit;
  - c) faza e zbatimit të kërkesave evropiane;
  - d) çdo ndryshim i bërë gjatë periudhës së tranzicionit.
- 6) Për të vlerësuar sa më shpejt përpjekjet e nevojshme dhe ndikimin e procedurës së konvertimit/certifikimit në operatorët e aerodromit, në nivelin e tyre do të bëhen analiza GAP të iniciuara me qëllim të rivlerësimit të kërkesave që vijnë nga zbatimi i legjislacionit evropian.
- 7) Në nivelin e operatorëve të aerodromit, programet e trajnimit do të zhvillohen dhe zbatohen në përputhje me procedurat e tyre për njohjen e kërkesave të UM Nr. 170/2022.
- 8) Periodikisht, bazuar në programin e konvertimit, çdo operator aerodromi do të hartojë plane zbatimi në mënyrë që të përputhen me kërkesat evropiane dhe do t'i dërgojë AAC statusin e tyre.
- 9) Faza e zhvendosjes së planeve për zbatimin e kërkesave për të respektuar kohën e dakordësuar në programin e konvertimit, do të diskutohet nga AAC me secilin operator aerodromi gjatë takimeve të punës ose takimeve në grup.
- 10) Gjatë takimeve të punës, aplikanti merr informacion në lidhje me afatin përfundimtar të paraqitjes së kërkesës për konvertim/certifikim, procedurat e zbatueshme, dokumentat e detyrueshme që duhet

të dorëzohen me aplikimin standard dhe çdo informacion tjetër të rëndësishëm në lidhje me procesin e certifikimit.

- 11) AAC gjithashtu informon aplikantin për periudhat kohore që kërkohen për të përfunduar secilën fazë të procesit të certifikimit dhe sugjeron dokumenta konkret për secilin operator të aerodromit për t'u plotësuar sipas programit të vendosur të konvertimit.

### 3.1.2. Fillimi i procesit të konvertimit/certifikimit

- 1) Pas përfundimit të fazës së informacionit, si dhe diskutimeve midis AAC-së dhe operatorit të aerodromit, kërkesa për certifikim bëhet duke paraqitur nga aplikanti pranë AAC aplikimin standard sipas Formës ACAA-DAD-AIM-200 "Forma për aplikim për certifikatë të aerodromit sipas kërkesave të UM 170/2022", të cilën mund ta aksesoni në faqen e web të AAC-së, të shoqëruar nga dokumentat mbështetëse të paraqitura në përputhje me ADR.OR.B.015 (b) dhe AMC/GM përkatëse.
- 2) Këto dokumenta duhet të dorëzohen 180 ditë përpara datës së përcaktuar në Programin e Konvertimit të dakordësuar paraprakisht.
- 3) Aplikimi tip i përmendur në 3.1.2. (1) nënshkruhet nga menaxheri përgjegjës i caktuar për secilin operator të aerodromit.
- 4) Në funksion të Nenit 6 (Konvertimi i certifikatave) të UM Nr. 170/2022, AAC do të lëshojë certifikata para datës së përmendur në 3.1.1. (5), nëse aplikanti i kërkesës i plotëson kushtet e Nenit 6, paragrafi (2) të UM Nr. 170/2022.
- 5) Që operatori i aerodromit të demonstrojë pajtueshmëri:
  - a) me ato kërkesa të VKM Nr. 1095, datë 24.12.2020 "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil;
  - b) Urdhri i Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 170, datë 13.09.2022 "Për miratimin e rregullores për përcaktimin e kërkesave dhe procedurave administrative që lidhen me aerodromet në Republikën e Shqipërisë";
  - c) me specifikimet e certifikimit (CS) të cilat janë të ndryshme nga kërkesat kombëtare në bazë të cilave është lëshuar certifikata ekzistuese;
  - d) me bazën e propozuar të certifikimit (shiko 3.1.3); do të përgatisë të gjitha provat e pajtueshmërisë, duke plotësuar Modelin e përputhshmërisë me UM Nr. 170/2022 sipas modelit të paraqitur në këtë procedure të shoqëruar me Deklaratën e Përputhshmërisë, sipas modelit të paraqitur në formën ACAA-DAD-GM8-CA-201, të Shtojcës 4 të kësaj procedure.
- 6) Për procesin e tranzicionit/konvertimit, derisa të paraqitet kërkesa, modeli mund të përfaqësojë bazën për hartimin e Planit të Vetë-implementimit të UM Nr. 170/2022, duke identifikuar kërkesat në fuqi dhe duke vendosur shkallën e përputhshmërisë, përkatësisht duke identifikuar masat përmirësuese dhe zbatimin tyre në një kohë e pranuar nga AAC.



- 7) Operatori i aerodromit, mund të propozojë mënyrë tjetër të pajtueshmërisë (AMOC) me rregullat në përputhje me kërkesat e paraqitura në 3.1.5. në përputhje me ADR.OR.A.015 ose mund të propozojë zgjidhje alternative për CS sipas kërkesave të paraqitura në 3.1.3.3 (ELOS), kur bën propozimin në lidhje me CB. Kjo do të duhet të bazohet në studime aeronautike ose risk assesment, të pranohet nga AAC në bazë të vlerësimit dhe të publikohet sipas rastit në AIP.
- 8) Dokumentat e kërkuara sipas ADR.OR.B.015 (b) (7) në lidhje me ADR.OR.D.015, do të paraqitet me të gjitha dokumentat mbështetëse të aplikimit të paraqitur.
- 9) Në përputhje me dispozitat e ADR.OR.B.015 (b) (8), operatori i aerodromit që kërkon një certifikatë do të paraqesë një datë me kërkesën e përmendur në 3.1.2. (1), duke përfshirë një kopje të Manualit të Operimit të Aerodromit.
- 10) Udhëzuesi për përpunimin e Manualit të Operimit të Aerodromit paraqitet në Kapitullin 3, Manuali i Aerodromit.
- 11) Për të përgatitur demonstrimin e pajtueshmërisë së operatorit të aerodromit me ADR.OR.B.025, ai do të hartojë Deklaratën e Përputhshmërisë, modeli i së cilës është paraqitur në Formën ACAA-DAD-GM8-CA-201, sipas Shtojcës 4 të kësaj procedure.
- 12) Në situatën kur menaxhimi i apronit kryhet nga një organizatë tjetër, në përputhje me kërkesat e rregullores, ofruesi i këtij shërbimi do të hartojë Deklaratën e Përputhshmërisë të ofruesit të shërbimeve të menaxhimit të apronit.
- 13) Kur aplikanti plotëson dokumentacionin e paraqitur për certifikim, ai do të marrë parasysh afatin përfundimtar të dakordësuar me AAC-në për paraqitjen e dokumentacionit të plotë të krijuar më parë - shiko 3.1.1. (10) përkatësisht 3.1.2. (2).
- 14) Kohët për plotësimin e secilës pjesë të modelit përcaktohen sipas programit të konvertimit të vendosur për secilin operator të aerodromit. Faktorë të tillë si: kompleksiteti i aerodromit, ekzistenca e punimeve të zhvillimit/modernizimit, data e përfundimit të certifikatës ekzistuese dhe ekzistenca, nëse ka, e ofruesit të shërbimit të menaxhimit të apronit merren parasysh.
- 15) Vlerësimi i aplikimit dhe dokumentacioni i paraqitur nga operatori i aerodromit, procesi i njoftimit për CB, pranimi ose jo i disa zgjidhjeve të propozuara nga operatori dhe faza aktuale e konvertimit të certifikatës, do të përshkruhen në përputhje me kërkesat e ADR.AR.C.015.
- 16) Brenda 30 ditëve nga data e regjistrimit të kërkesës së konvertimit/certifikimit dhe dokumentacionit mbështetës, operatori i aerodromit informohet për pranimin ose jo të kërkesës.
- 17) Nëse, pas analizës së kërkesës për konvertim/certifikim, dokumentacioni i paraqitur kërkon plotësimin, afati 30-ditor i përmendur në 3.1.2. (16) do të merret parasysh nga paraqitja e plotë e dokumentave mbështetës të kërkuar.

### 3.1.3. Propozime të operatorit të aerodromit në lidhje me Bazën e Certifikimit - CB

#### 3.1.3.1. CB – Përmbledhje

- 1) Në mënyrë që të propozohet Baza e Certifikimit (CB) nga operatori i aerodromit, është e nevojshme të përcaktohen kushtet e operimit.
- 2) Kushtet e operimit të secilit operator të aerodromit janë të detajuara në aplikimin për konvertimin e certifikatës/aplikimit për certifikim të paraqitur në Shtojcën 2.
- 3) Operatori i aerodromit propozon bazën për përgatitjen e CB-së (shiko Shtojcën 1) udhëzuesin për krijimin e CB dhe përshkrimin e zgjidhjeve alternative për CS pas plotësimit të modelit të përputhshmërisë së CB-së (Shtojca 1, Pjesa 1) sipas elementeve vijuese:
  - a) mjetet e vëna në dispozicion brenda sistemit të kontrollit dhe lëvizjes në zonën e manovrimit;
  - b) mjetet e nevojshme për përmbushjen e procedurave në kushtet me shikueshmëri të ulët;
  - c) elementët që lidhen me infrastrukturën që rrjedhin si rezultat i mundësive të avionëve operues me një kod superior mbi kategorinë e aerodromit;
  - d) elementë të tjerë në varësi të specifikës, kompleksitetit dhe nivelit të trafikut të kryer në aerodrom, për të cilat do të konsiderohet se CS/GM që korrespondon me operimin do të theksohet në përputhje me rrethanat.
- 4) Duke pasur parasysh që CB përbëhet nga CS, ELOS dhe SC e përshkruar në ADR.AR.C.020 të UM Nr. 170/2022, operatori i aerodromit mund të jetë i certifikuar për operimet e deklaruara në kushtet e plotësimit të kërkesave të lidhura me CS dhe GM, ose në kushtet në të cilat kërkohet dhe demonstron një ELOS për një CS.
- 5) Nëse AAC përcakton më pas ekzistencën e një SC (duke marrë parasysh se është pjesë e CB, në kushtet e UM Nr. 170/2022 dhe të konsideratave të paraqitura në Shtojcën 1 ose themelon DAAD (shiko formën ACAA-DAD-GM8-CA-202 të Shtojcës 4) , operimet e shoqëruara të CS mund të kryhen me kufizime që korrespondojnë me nivelin e pajtueshmërisë dhe implikimet e sigurisë në operim.
- 6) Për të bërë ndryshimin midis ELOS dhe SC, operatori i aerodromit do të marrë parasysh kriteret e paraqitura në Shtojcën 1.
- 7) Gjithashtu në Shtojcën 1 është paraqitur Diagrami i trajtimit të ndryshimeve.

#### 3.1.3.2. CS - Specifikimet e certifikimit

Shiko ADR.AR. C.020 (a) të UM Nr. 170/2022.

- 1) Në funksion të GM1 ADR.AR.C.015, operatori i aerodromit propozon CS të zbatueshme për aerodromin (shiko Shtojcën 1), duke supozuar pajtueshmërinë me kërkesat e zbatueshme duke nënshkruar Deklaratën e Përputhshmërisë.
- 2) Me propozimin e aplikantit të CB-së, aplikanti do të ndjekë CS në fuqi, si dhe GM pas tyre.

- 3) AAC mund të modifikojë ose shtojë CS shtesë në propozimin e aplikantit, duke ndjekur kushtet e funksionimit dhe elementët që aplikanti ka futur në aplikim.
- 4) Para krijimit dhe njoftimit të CB nga AAC në përputhje me ADR.AR.C.020 (a), AAC do të shqyrtojë dhe vlerësojë përmbajtjen e kërkesës dhe dokumentacionin përkatës, përfshirë SC-në e propozuar dhe çdo dispozitë për të cilën propozohet pajtueshmëria, e demonstruar nga operatori i aerodromit në një mënyrë tjetër në përputhje me AMC2 ADR.AR.C.015 (c).
- 5) Pas vendosjes dhe njoftimit të CB, CS, AAC do t'i njoftojë kërkuarit se CB, CS janë në fuqi në datën e paraqitjes së kërkesës për konvertim/certifikim në përputhje me ADR.AR.C.020 (a).
- 6) Me anë të derogimit nga 3.1.3.2. (3), AMC1 ADR.AR.C.020 (b) ose (c) mund të aplikohen.

### **3.1.3.3. Niveli ekuivalent i sigurisë në operim – ELOS**

Referuar UM Nr. 170/2022, ADR.AR.C.020 (b), AMC1 ADR.AR.C .020 (b) (c), GM1.ADR.AR.C.020 (b):

- 1) Në funksion të ADR.AR. C.020 (b), aplikanti mund t'i propozojë AAC, që të demonstrojë një nivel ekuivalent të sigurisë në operim (ELOS), si një alternativë për një ose më shumë CS.
- 2) ELOS nënkupton përkufizimin e një zgjidhjeje teknike, mjeteve (modelimit, teknikës, procedurave, etj.) Të lidhura me një studim aeronautik/vlerësim të rrezikut sipas 2.1.6. për të demonstruar se objektivat e sigurisë të përmendura në CS janë përmbushur.
- 3) Në mënyrë që ELOS të pranohet nga AAC, aplikanti duhet t'i tregojë AAC-së, se zgjidhja e propozuar siguron një nivel ekuivalent të sigurisë në operim, i cili nuk është më i ulët se ai i shoqëruar me CS-të përkatëse në fuqi.
- 4) Kur AAC vlerëson një propozim të një aplikanti, i cili ka kërkuar të tregojë një nivel ekuivalent të sigurisë në operim, ai do të vlerësojë sipas GM1 ADR.AR.C.020 (b), nëse propozimi plotëson kërkesat e CS dhe nëse ka ndonjë ndërlidhje/marrëdhënie ndërmjet CS, me të cilat lidhet propozimi, me ndonjë CS ose kërkesë tjetër:
  - a) të identifikojë ndonjë implikim të ndryshimeve në projekte, elementë operacional, njerëzor ose me elementë të tjerë aeroportual;
  - b) demonstroi nëse këto ndërlidhje/marrëdhënie dhe implikime janë adresuar në mënyrë korrekte dhe të përshtatshme nga aplikanti.
- 5) Pranimi i ELOS nga AAC do të bëhet duke marrë parasysh Standardet ose Praktikat e Rekomanduara të parashikuara nga Konventa e ICAO-s dhe Anekset e saj në fuqi, në kohën e aplikimit për konvertim/certifikim.
- 6) Sa i përket mënyrave të përdorimit të ELOS, ato mund të përdoren pa diskriminim në vend të CS-ve përkatëse, nëse kanë të njëjtën cilësi dhe të njëjtin nivel sigurie në operim.
- 7) Të gjitha ELOS-të e aplikueshme përshkruhen në Manualin e Operimit të Aerodromit si dhe publikohen, sipas rastit.

### 3.1.4. Pajtueshmëria me kërkesat në lidhje me organizimin dhe operimet

- 1) Për demonstrim nga operatori i aerodromit për pajtueshmërinë me kërkesat e VKM Nr. 1095, datë 24.12.2020 "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil", përkatësisht me kërkesat e UM Nr. 170/2022 në lidhje me organizimin (Shtojca III - Pjesa ADR.OR) dhe operimet (Shtojca IV - Pjesa ADR.OPS), operatori i aerodromit do të përgatisë të gjitha provat në lidhje me pajtueshmërinë, duke plotësuar formularin e pajtueshmërisë në Shtojcën 2 në lidhje me organizimin dhe operimet.
- 2) Në këtë mënyrë, pas përfundimit të plotësimit të të gjitha pjesëve do të merren parasysht:
  - a) shkalla e pajtueshmërisë së operatorit të aerodromit dhe dëshmia e pajtueshmërisë, si dhe devijimet që rezultojnë;
  - b) propozimi i operatorit të aerodromit për AMOC.
